

**AKT-THMELIMI**  
**PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**RADIO "MUZIKA JONE" SHPK**



**NENI 1**

Bazuar ne ligjin 7667, date 28 Janar 1993, per regjistrimin tregtar dhe formaliteti qe duhet zbatuar nga shoqeria tregtare, si me poshte:

1. **Alban Jaho**, i biri i Nuriut lindur me 1969, banues ne Tirane ne Rrugen "Kavajes "P.166/1

Sot, me date, 8/09/2003, eshte dakort te ushtrojne veprimtarine private si ortak i vetem, duke krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar RADIO "MUZIKA JONE" sh.p.k ne kushtet qe vijojne.

**NENI 2**

Selia do te jete ne Tirane Qendren Nderkombetare te Kultures

**NENI 3**

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj mbi dhjete vjet. Permbajtja e Aktit te Themelimit dhe kushtet e tij, te percaktuara ne te, do te behen gjithmone me shkrim.

**NENI 4**

Objekti i shoqerise eshte:  
Transmetues Radio-Televiziv Lokal.

**NENI 5**

Ne fillim te veprimtarise ekonomike e financiare, shoqeria disponon nje kapital prej 100 000(njeqindmije)Lekë.

**NENI 6**

Kapitali i shoqerise mund te shtohet sipas rritjes se veprimtarise ekonomike te saj. Te ardhurat do te sigurohen nepermjet veprmtarise private te percaktuara ne nenin kater te kesaj kontrate.

**NENI 7**

Kapitali themeltar perbehet nga kontributeve te ortakut te vetem ne shumen prej 100 000(nje qind mije)Lekë.

Fitimet e arritura ne veprimtarite private do të peritohen nga ortakut I vetem.

**NENI 8**

Ortakut ka te drejte te jap mendime dhe te kontrollojne veprimet financiare qe do te kryeje shoqeria e tij.

**NENI 9**

Ortakut do te jete pergjegjes per çdo thyrje te rregullave ligjore, ekonomike dhe financiare te aktivitetit te tij.

**NENI 10**

Ortakut ka per detyre te marren pjese ne reziqet e veprimtarise se shoqerise deri ne masen e plote te kapitalit financiar.

**NENI 11**

Akti i Themelimit, nenshkruhet nga ortakut, ne baze te statutit te miratuar prej tij, per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar RADIO "MUZIKA JONE" sh.p.k.

**NENI 12**

Kembimi i monedhes kombetare shqiptare, Lekë, ne monedhe te huaje dhe anasjelltas do te behet ne perputhje me kursin zyrtar te percaktuar nga Banka e Shqiperise, nga Bankat e tjera shterore, private apo ne tregun privat te valutes.

**NENI 13**

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe per ceshtje qe nuk rregullohen ne kontrate do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar te punes.

**NENI 14**

Ortakut ka per detyre te zbatojne rregullat dhe udhezimet e inspektoriateve te ndryshme si: ai financiar, sigurimi teknik, e tjera.

**NENI 15**

Akti i Themelimit eshte i vlefshem mbi dhjete vjet, me te drejte te riparteritjes me miratimin e ortakut.

**NENI 16**



Mosmarveshjet qe mund te lindin midis ortakeve dhe personave te trete fizike, apo juridike apo te punesuares sipas kontrates se punes, do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen per kompetence Gjykates se Rrethit Tirane.

### NENI 17

Akti i Themelimit eshte redaktuar ne kater kopje, e cila pasi u lexua dhe u miratua nga ortaku. nenshkruhet prej tij pa vrejteje.

Administratori do te jete zoti ALBAN JAHO, pra ortaku I vetem.

Ky Akt- Themelimi hyn ne fuqi pasi nenshkruhet nga ortaku.

Akti i Themelimi u nenshkrua sot me date, 8/09/2003.

ORTAKU

*Alban Jaho*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE  
NR. ~~42~~ REP. ~~130~~ KOL



VERTETIM

Ne Tirane sot m,e date 8/09/2003 (dymij e tre ) diten e hene u paraqite personalishte ortaku i vetem i SHPK Radio "MUZIKA JONE" Z. Alban Jaho i biri i Nuriut , lindur ne Tirane , ne 31/05/1969,banues ne Tirane,madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , i identifikuar me pashaporte NR 1543599, i cili nenshkroje sa me siper, dhe une noteria e vertetova sipas ligjit.

NOTERE

*Ermedine Lleshi*

*dy*



**STATUTI I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
RADIO "MUZIKA JONE" sh.p.k.**

**I. HYRJE**

1.1 Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar RADIO "MUZIKA JONE" SHPK qe nga ky moment dhe me pas referohet si shoqeri, krijohet mbi bazen e inisiatives dhe kapitalit personal te ortakut te vetem:

*ALBAN JAHO i biri i Nuriut ,lindur 31/05/1969, banues ne Tirane, rruga "Kavajes" P.166/II*

Shoqeria krijohet dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat ketij statuti sidhe te ligjslacionit te Republikes se Shqiperise.

1.1 Kjo shoqeri, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit te saj themeltar.

**II. OBJEKTI**

**TRANSMETIM RADIO TELEVIZIV LOKAL.**

**III. EMRI, SELIA, TERRITORI.**

III.1 Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do te quhet RADIO "MUZIKA JONE" SHPK.

Shoqeria do te fitoje personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.

III.2 Shoqeria do te kete qendren e saj ne qytetin e Tiranes, ku do te zhvillohet aktiviteti i saj kryesor ekonomik. Seline e saj te pare, shoqeria do ta kete ne Tirane, rruga "Qendra Nderkombetare e Kultures .

III.3 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

III.4 Shoqeria mund te krijojë dege te tjera edhe ne rrethe te tjera te vendit.

**IV. KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE**

IV.1 Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i ortakut te vetem ne shumen prej 100 000(nje qind mije)Lekë.



IV.2 Kapitali themeltar do te depozitohet ne nje banke te qytetit te Tiranës para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

IV.3 Kapitali themeltar ndahet ne pjese te barabarta, vlera nominale e te cilave eshte 1000(njemije)Lekë.

IV.4 Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvogelohet ne varesi te rezultateve dhe nevojave ne perputhjeve me dispozitat e legjislacionit ne fuqi.

IV.5 Kapitali themelor mund te trasferohet jashte shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi.

IV.6 Kapitali themeltar eshte lirisht i trasferushem ne rruge trashgimnie. Bashkeshortja, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, me vendim te ortakut te vetem dhe ne baze te legjislacionit ne fuqi.

## V. FONDET E SHOQERISE

V.1 Shoqeria percakton fondet e meposhteme:

a-Fondi themelor (qarkullues).

b-Fondi rezerve

c- Fonde te tjera, te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimatarise se saj.

V.2 Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohen me vendim te organit drejtues te shoqerise.

## VI. ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

VI.1 Si organ i vetem drejtues i shoqerise eshte ortakut i vetem, i cili eshte dhe administrator i saj.

VI.2 E gjithë veprimataria e shoqerise percaktohet nga administratori i saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Administrator i kesaj shoqerise eshte zoti **Alban Jaho**.

VI.3 Per administrimin e shoqerise ose te aktiviteve te vecanta te saj, administratori mund te emeruje nje ose disa administratore te mundshem.

VI.4 Kompetencat e administratoreve te mundshem, ne menyre te pergjithshme percaktohen ne statut dhe detajohen e konkretizohen ne aktin e tyre te emerimit.

VI.5 Shoqeria nuk merr persiper, veprimet e ndryshme te mundshme te administratorit te mundshem ne marredhenie me te tretet, te cilat i tejkalojne kompetencat e tij te percaktuara ne statut dhe ne aktin e emerimit.

VI.6 Administratori për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara sidhe menyrën e mbajtjes së regjistrit të veprimeve kontabile emerone, një ose disa ekspert kontabel për një periudhë prej gjashtë vitesh financiare.  
Emertimi i eksperteve kontabel është i detyrues për rastet e parashikuara me ligj.

### **KOMPETENCAT E ORTAKUT TË VETEM**

Ortaku i vetem si organ vendimor i Sh.P.K. ka në kompetencën e tij trajtimin e zgjidhjen e çdo problemi që ka të bëjë me shoqërinë.

Për efekt të evidencimit e të përcaktimit të kompetencave ekskluzive të ortakut të vetem që nuk mund të trajtojnë askush tjetër e që nuk mund të nënshkruhet prej tij, vetem në emër të ortakut të vetem janë :

- Miratimi dhe ndryshimi i statutit
- Organizimi dhe ndryshimi i organeve të SH.P.K.
- Emerimi dhe shkarkimi i administratorit, kur nuk e kryen vetë këto detyra
- Blerja, kembimi, e shitja e pasurisë së palujtshme dhe e të drejtave reale mbi të
- Marja e kredive, huave, dhe dhenija e tyre
- Marja pjesë ose heqja dorë nga shoqëri të tjera
- Analiza e miratimi i Raportit të administrimit, të inventarit dhe llogarive vjetore
- Pranimi në punë dhe pushimi nga puna i punonjësve, si dhe caktimi i pagave, e caktimin e shpërblimeve të tjera
- Pushimi i veprimtarisë së personit juridik dhe marja e masave, për operacionet e likuidimit, caktimi i likuidatorve.

Për këto probleme nënshkruhet vetëm me emërtimin e ortakut të vetem..

### **VII KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Për sa kohë që shoqëria do të përbehet nga një ortak i vetem, administratori i saj do të ketë disa kompetenca ekskluzive.

VII.1 Administratori, vendos për ndryshime në statut dhe miraton rregulloret e shoqërisë ose të sektoreve të vecanta të saj.



VII.2 Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.

VII.3 Emeron dhe shkarkon administratoret e mundshem te shoqerise si dhe percakton kompencat e plota te tyre.

VII.4 Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve te ndryshme sidhe fitimin e realizuar.

VII.5 Vendos per krijimin e degeve ose te perfaqsize si dhe per krijimin e shoqerive apo ridermarjeve te perbashketa.(Joint Venture).

VII.6 Vendos per marjen e kredive si dhe per mbarimin e shoqerise nese dokumentat financiare, rezultatet e shoqerise tregojne me humbje.

VII.7 Vendos per shenderimin e shoqerise nga sh.p.k ne shoqeri te llojeve te tjera.

VII.8 Miraton ose realizon marredheniet me te rendesishme te shoqerise me persona te tjere juridike ose fizike.

VII.9 Miraton ose realizon cmimet e shitjes ose te sherbimeve.

VII.10 Vendos per pagat e personelit te punesuar ne shoqeri.

VII.11 Pervec kompetencave te lart permendura, te cilat jane eskuzive per te, administratori ne rast se nuk ka emeruar administratore te mundeshem, kryen dhe kompetencat qe ne kete statut jane percaktuar per keta te fundit.

## **VIII KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT TE MUNDSEHM**

Kompetencat e plota e administratorit te mundeshem, percaktohen ne aktin e emerimit te tij. Vec te tjerave qe mund te percaktohen ne kete akt, administratori i mundshem ka edhe keto kompetenca:

VIII.1 Kujdeset per funksionimin e perditshem dhe normal te aktivitetit ekonomik dhe financiar te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi dhe ja paraqet per shqyrtim administratorit.

VIII.2 Pregatit dokumentacionin dhe relacionet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi dhe ja paraqet per shqyrtim administratorit.

VIII.3 Kordinon veprimtarine e personelit te punesuar ne shoqeri.

VIII.4 Shqyrton oferta dhe pregatit kontrata, te cilat ja paraqet administratorit per miratim.



VIII.5 Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organe te ndryshme shteterrone ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.

VIII.6 I propozon administratorit cmimet e shitjes dhe te sherbimeve sidhe per pagat e personelit te punesuar ne shoqeri.

VIII.7 I propozon administratorit rregulloret per sektore te vecante te veprimtarise se shoqerise.

### **VIII. NDARJA E FITIMIT**

IX.1 Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme, pagave te punonjesve etje, ortakut te vetem i mbetet ne dispozicion fitimi neto.

IX.2 Fitimi neto mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themeltar, per shtimin e tij me kapital ne natyre, per shtimin e fondeve te shoqerise, e tjera.

IX.3 Fitimi neto mund te perdoret dhe per qellime te tjera.

### **IX. KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kjo shoqeri krijohet per nje afat mbi 10 vjet.

### **X. MENYRA E PERFAQËSIMIT TE SHOQERISE**

Shoqeria perfaqsohet nga administratori i saj, ne te gjitha marredheniet e ndryshme juridike.

Ajo mund te perfaqësohet dhe nga ndonje person tjetër i paisur me prokure te posacme ose me autorizim te veçante.

### **XI. MARREDHENIET E PUNESIMIT**

Cdo person i punesuar ne shoqeri, duke perfshire dhe administratorin e mundshem, konsiderohet si i tille mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe administratorit te shoqerise ne perputheje me legjislacionin e punes ne fuqi.

### **XII. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE DHE KONFIDENCIALITETI**

Cdo person i caktuar si administrator i mundshem, ose i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te ruaje karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informacionit, te pervojës se shkëmbyer sidhe te cdo





materiali tjetër konfidencial. Ai është gjithashtu i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës së bashku dhe nga vendimet e administratorit.

### XIII MBARIMI I SHOQERISE

XIII.1 Veprimtaria e shoqërisë mbaron me vendim të organit të saj drejtues, në rast se aktiviteti i saj nuk rezulton fitim prurës, për shkak të forcës më të madhe së bashku dhe për shkak të tjerave ligjore.

XIII.2 Shoqëria mund të mbarojë dhe me anë të riorganizimit, nëpërmjet formave të bashkimit të bashkimit.

XIII.3 Gjate fazës së likuidimit të shoqërisë, administratori, administratori i mundshëm dhe ekspertët kontabel kanë të njëjtin përgjegjësi.

### XIV DISPOZITA TË FUNDIT

XIV.1 Viti financiar i shoqërisë fillon me një janar dhe përfundon me tridhjetë e një dhjetor.

XIV.2 Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Shqipërisë.

XIV.3 Shoqëria do të ketë vullnet të saj, formë dhe madhësi të cilat përcaktohen nga administratori i saj.

Ky statut u miratua nga unë ortak i vetëm dhe administratori i shoqërisë, sot, me datë, 8/09/2003

ORTAKU I VETËM

Alban Jaho

*Alban Jaho*

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA E NOTËRVE TIRANË  
NR. ~~122~~ REP-234 KOL

VERTETIM

Në Tiranë sot me datë 8/09/2003 (dymij e tre) ditën e hënë u paraqitë personalisht ortak i vetëm i SHPK Radio "MUZIKA JONË" Z. Alban Jaho i biri i Nuriut, lindur në Tiranë, në 31/05/1969, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë NR 1543599, i cili nënshkroi së bashku me unë notërinë e vertetimit sipas ligjit.

*Pranë*

*Alban Jaho*

